



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT **K R Y E T A R I**

Nr. 1021/7 Prot.

Tiranë, më 26/12/2016

V E N D I M

Nr. 164, Datë 26/ 12 /2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË KËSHILLIN E QARKUT GJIROKASTËR “MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10,15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, vlerësimin financiar dhe menaxhimin e administrimin e aseteve të qëndrueshme”, të ushtruar në Këshillin e Qarkut Gjirokastrë, për periudhën nga data 01.01.2013 deri 30.06.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastrë nuk ka hartuar, objektivat, planet vjetore dhe ato strategjike të institucionit, nuk ka hartuar rregullore për arkivimin e dokumenteve dhe as rregullore të kodit të etikës. Nuk janë hartuar programe trajnimi për punonjësit, nuk është ngritur grupi i punës për menaxhimin e riskut dhe nuk ka regjistër risku dhe për rrjedhojë nuk ka përcaktim të nivelit të pranueshëm të riskut. Mungon hartimi i listës së proceseve kryesore të punës që kryen punonjësi dhe i gjurmës së auditimit për këto procese të punës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 20, pika 2 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, nenin 8, 16, 20, 22, 23, 24 të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, kapitullin III, shtojcën nr. 5, 7 të “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

1.1.Rekomandimi: Këshilli i Qarkut të hartojë objektivat, planet vjetore dhe strategjike të institucionit. Të hartohet dhe miratohet rregullorja e brendshme për zbatimin e legjislacionit për arkivat dhe rregullorja për kodin etik. Të merren masa për hartimin e programeve për trajnimin e punonjësve. Të hartohet regjistri i riskut dhe lista e proceseve të punës nga sektorët kryesor, si dhe gjurma e auditimit për këto procese. Të kryhet në vazhdimësi monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe dobësitë e tij të pasqyrohen në raportin vjetor mbi funksionimin e këtij sistemi.

Brenda muajit shkurt 2017

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i buxhetit, konstatohet se Këshilli i Qarkut Gjirokastrë ka detyrime të trashëguara nga ish-Këshillat e Rretheve Gjirokastrë, Përmet e Tepelenë për vlerën **18 milion lekë**, nga të cilat 17 vendime për largime nga puna në vlerën 14 milion lekë dhe 15 vendime shpronësimi pasurish të paluajtshme në vlerën 4 milion lekë, të cilat kanë ndikuar negativisht në buxhet.

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë ka detyrime për 17 vendime gjyqësore, për largime të padrejta nga puna, me efekt financiar në vlerën prej 21,944,457 lekë, nga të cilat vlera prej 8,27,735 lekë ka dhënë efekt negativ në buxhetin e institucionit në periudhën 2013-2016, ndërsa vlera 13,616,722 lekë pritet të jap këtë efekt në buxhetin e periudhës së ardhshme.

2.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut të nxjerrë përgjegjësitë ligjore e administrative ndaj personave shkakhtar, që kanë krijuar detyrimin 18 milion lekë për 32 vendime gjyqësore, çka ka ndikuar negativisht në buxhetin e shtetit si dhe të marrë masa për planifikimin e fondeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë të marrë masa në rastet e largimeve nga puna të punonjësve të zbatohen të gjitha procedurat e duhura ligjore me qëllim që të shmangen efektet financiare në buxhet nga zhvillimi i proceseve gjyqësore.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2013-2016 në Këshillin e Qarkut Gjirokastrë kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 16 punonjës, të cilët pas largimit nuk kanë bërë dorëzimin e aktive në përdorim. Në urdhrat e largimit nuk është përcaktuar detyrimi i punonjësit për dorëzimin e detyrës dhe as afatet për këtë qëllim, duke bërë që problematika të mbartet dhe në punonjësit e emëruar rishtazi, të cilët nuk marrin në dorëzim detyrën me procesverbal, si dhe duke krijuar vështirësive në administrimin e dokumenteve dhe informacionit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën

13 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 19, 20 dhe 21 VKM nr. 360, datë 14.07.2000 “Për lirim nga shërbimi civil, pikën 50 të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 ”Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.

3.1.Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, për çdo rast të ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës apo transferimit të punonjësve, të mos bëjnë likuidimin përfundimtar të punonjësve pa bërë më parë dorëzimin me procesverbal të detyrës dhe praktikave të administruara deri në çastin e ndërprerjes të marrëdhënieve.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se regjistri i tokës bujqësore të administruar nga kadastra e qarkut ka mangësi në drejtim të gjendjes juridike të tokës, pasi prej njërive të vetëqeverisjes vendore nuk është respektuar Kreu IV, pika 2 e VKM nr. 121, datë 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki”, lidhur me detyrimet e njërive vendore.

4.1. Rekomandim: Këshilli i Qarkut, të marrë masat e nevojshme institucionale dhe ligjore për plotësimin e Rregjistrimit të Tokës, duke u kërkuar njërive të vetëqeverisjes vendore të gjithë informacionin e nevojshëm, në përputhje me kërkesat specifike të VKM nr. 121, datë 17.02.2011.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në 3 objekte investimesh të financuara nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë dhe ish-njërive vendore Progonat dhe Kurvelesh, dokumentacioni teknik i dosjeve të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike rezultoi me mangësi, dosje për të cilat nga verifikimi në terren i investimeve rezultuan edhe diferenca në volume pune të pakryera. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 3, 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, dhe kreu I, pika 1, të VKM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolauditimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, si dhe kreu II, pika 8.3 si dhe me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pikat 2, 3, 9, 11 dhe 12.

5.1. Rekomandim: Këshilli i Qarkut të marrë masa për monitorimin e vazhdueshëm të investimeve, të cilat mund të përfitohen nga fondet e buxhetit të shtetit apo projekteve me financime të huaja. Monitorim të kryhet nëpërmjet ngritjes së grupeve me specialistë të fushës, në varësi të llojit të investimit, lidhur me dokumentacionin e objektit, zërat e punimeve, dokumentimin nëpërmjet materialeve fotografike të proceseve të maskuara si dhe kontrollin e cilësisë të materialeve me kërkesat e projektit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për periudhën 2013-2015 nuk ka administruar me dokumentacion shpenzimet për automjetin me targa AA356ET, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësinë e sektorit publik” dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, pasi për çdo vit ka shpenzuar për karburant dhe pjesë këmbimi, më shumë se vlera fillestare e tij; ka aplikuar normativa të larta konsumi karburanti, në masën 500 litra/muaj; ka lejuar daljen nga magazina të karburantit dhe pjesëve të këmbimit pa urdhër të eprorit për

vitin 2015; ka lejuar furnizimin me karburant pa kryer akt rekordimet për efekt të justifikimit të harxhimit të karburantit, si dhe për vitin 2015 nuk janë mbajtur fletudhëtimet.

6.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut të marrë masa për kalimin në ankand ose nxjerrjen jashtë përdorimit të automjetit me targa AA356ET, pasi automjeti shpenzon për një vit kalendarik për karburant dhe pjesë këmbimi më shumë se vlera fillestare e tij brenda vitit kalendarik. Zyra e Shërbimeve dhe e Financës të rishikojë normativat mujore të karburantit për automjetet dhe të bëjnë rakordimet mujore periodike të karburantit për efekt të administrimit të tij.

Brenda muajit shkurt 2017

7. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastrë nuk ka zbatuar **rekomandimet e KLSH**, dërguar me shkresën nr. 444/6, datë 06.09.2013, pasi nuk ka kontabilizuar dhe nuk ka arkëtuar masat për shpërblim dëmi për vlerën **1,120,239 lekë**, pagesa të përfituara tepër, në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008, ndryshuar me VKM nr. 693, datë 18.08.2010, me VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve”.

7.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të KLSH, sipas shkresës nr. 444/6, datë 06.09.2013, për arkëtimin nga 20 punonjës të vlerës prej **1,120,239 lekë**, si pagesa të përfituara tepër.

Brenda muajit mars 2017

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në nenin 15 shkronja (b) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi procedurave administrative”, pjesa V, kreu I “Akti administrativ”, nenet 98-102, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 21-33 “Funksionimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil”, nenet 608-628 në vijim dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, **nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë**, të nxirren aktet administrative përkatëse (Vendimet ekzekutive) dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile, me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 5,232,016 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në objektet “*Riparime në segmentin rrugor Progonat - Tepelenë*” Fshati i Vjetër (Faza I + Faza II) dhe Hosi i Zallit, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume të punimeve të pakryera në vlerën **4,554,052 lekë** pa t.v.sh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen

dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pika 1, UKM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3 si dhe me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pikat 2, 3, 9, 11 dhe 12 si dhe me kontratat e sipërmarrjes së punimeve datë 02.02.2015 dhe datë 18.02.2015 të lidhura mes OE “██████” sh.p.k dhe ish-titullarit të AK për ish-Komunën Kurvelesh dhe si dhe me kontratën nr. 03 reference datë 12.06.2015 të lidhur mes ish-titullarit të AK Këshilli i Qarkut Gjirokastër.

1.1. Rekomandim: Nga Këshilli i Qarkut Gjirokastër, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **4,554,052 lekë** pa t.v.sh nga operatori ekonomik “██████” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratat datë 02.02.2015, datë 18.02.2015 dhe nr. 03 reference datë 12.06.2015 me objekt “Riparime në segmentin rrugor Progonat-Tepelenë” Fshati i Vjetër (Faza I+Faza II) dhe Hosi i Zallit, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda muajit shkurt 2017

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave në Këshillin e Qarkut Gjirokastër u konstatuan se në 3 raste janë kryer pagesa të tepërta, për vlerën totale prej **338,391 lekë**, përkatësisht:

-Ish-punonjësi B.L. për periudhën 2013-2014, është paguar për kualifikim pas universitar (master), duke përfituar padrejtësisht në total vlerën 185,520 lekë, në kundërshtim me pikën 7 të VKM nr. 55, datë 11.08.2011 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.

-Punonjësja L.L. dhe ish-punonjësi L.T. me detyrë specialiste pranë qendrës ditore për zhvillimin e fëmijëve me autizëm, për periudhën gusht-dhjetor 2013 janë paguar tepër për pagën e pozicionit, duke përfituar padrejtësisht L.L. vlerën 68,554 lekë dhe z. L.T. vlerën 84,317 lekë.

2.1.Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastër të kontabilizojë detyrimin prej **338,391 lekë** dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e kësaj vlere respektivisht nga B.L. 185,520 lekë, L.L. 68,554 lekë dhe L.T. 84,317 lekë.

Brenda muajit prill 2017

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan shpenzime të kryera në kundërshtim me kërkesat ligjor për vlerën prej **130,000 lekë**, sipas urdhër shpenzimit nr. 275, datë 04.6.2015, shpenzuar për një drekë me rastin e mbylljes të Festivalit Folklorik Kombëtar Gjirokastër, me pjesëmarrjen e 145 personave të Këshillit Qarkut Gjirokastër dhe rretheve tjera, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar.

3.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastër të arkëtojë nga Kryetari i Qarkut S.M. dhe Shefi i Financës V.M. vlerën prej **130,000 lekë**, shpenzime të paligjshme për dreka, sipas urdhër shpenzimit nr. 275, datë 4.6.2015.

Brenda muajit shkurt 2017

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua vlere prej **110,240 lekë**, si tejkalim të normativave të karburantit, si rezultat i mos rekordimit të kilometrave të

përshkuara me furnizimet dhe me normativat e miratuara të karburantit, për automjetin me targa AA356ET, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, përkatësisht:

-për vitin 2013 rezultoi diferenca prej 308 litra për vlerën 54,440 lekë, karburant i pa justifikuar, për A.G. 24,440 lekë (janar-prill 2013) dhe N.B. 30,000 lekë (maj- dhjetor 2013), pasi në fletudhëtimet pasqyrohen 52417 km të përshkuara gjithsej, në vend të 55500 km në fakt, me diferencë minus 3083 km, ose 308 litra.

-për vitin 2014 rezultoi diferenca 310 litra për vlerën 55,800 lekë, karburant i pa justifikuar, për N.B. pasi në fletudhëtimet pasqyrohen 56247 km gjithsej të përshkuara, në vend të 59380 km në fakt, me diferencë mangët 3133 km, ose 310 litra.

4.1.Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastrë të arkëtojë vlerën **110,240 lekë**, përkatësisht nga A.G. 24,440 lekë dhe N.B. 85,800 lekë, diferencë karburanti për vitin 2013 dhe 2014, pasi nuk rakordojnë kilometrat e përshkuara nga mjetet, me sasinë e karburantit të marrë në dorëzim (furnizimi) me normativat e miratuara për konsumin e karburantit, për automjetin me targa AA356ET.

Brenda muajit mars 2017

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve me bankën, për vitin 2013-6/mujorin 2016, u konstatuan **dieta të pa argumentuara** dhe me mangësi dokumentare, për vlerën **89,000 lekë**, përfituar nga 10 punonjës të administratës së Këshillit të Qarkut, sipas urdhër shpenzimeve respektive, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”.

5.1.Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastrë të arkëtojë vlerën prej **89,000 lekë**, përfituar dieta të tepërta, për vitin 2013-6/mujorin 2016, përkatësisht: S.M. 14,500 lekë, A.H. 22,000 lekë, M.H. 12,500 lekë, S.K. 5,500 lekë, E.L. 5,500 lekë, K.C. 5,500 lekë, B.H. 3,000 lekë, S.C. 3,000 lekë, A.G. 12,000 lekë, M.L. 5,500 lekë.

Brenda muajit mars 2017

6. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastrë ka kryer **shpenzime pa mbështetje ligjore**, për vlerën prej 10,058 lekë (5,529+4,529), për 2 gjoba të vendosura nga mos pagesa e taksave vjetore të mjeteve të përdorura të vitit 2013-2014, sipas urdhër shpenzimit nr. 142, datë 17.3.2015 dhe nr. 190, datë 21.4.2015, pasi janë likuiduar padrejtësisht nga fondet e KQ dhe jo nga përgjegjësit, në shkelje të ligjit nr. 10346, datë 04.11.2010 “Për ankandet”, i ndryshuar nenet 1, 3, 4 dhe 6, të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor”, i ndryshuar neni 99- Tarifat e regjistrimit të automjeteve, neni 102- Detyrimet që rrjedhin nga heqja prej qarkullimit të mjeteve, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 2.

6.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastrë të arkëtojë vlerën prej **10,173 lekë**, nga S.M. dhe V.M. për 2 gjoba të vendosura nga mos pagesa e taksave vjetore të mjeteve të përdorura të vitit 2013-2014, sipas urdhër shpenzimit nr. 142, datë 17.3.2015 dhe nr. 190, datë 21.4.2015, pasi janë likuiduar padrejtësisht nga fondet e KQ Gjirokastrë në vend të personave përgjegjës, sipas urdhrit nr. 46, datë 21.4.2015.

Brenda muajit janar 2017

C. MASA ADMINISTRATIVE

C.1. Për Ministrinë e Zhvillimit Urban (Komisioni i Licencave)

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit”, në nenin 13, nenin 25, pika 1/a, 1/e, nenin 41, kreu VI-të, “Sanksione dhe dispozita kalimtare”, të “Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit”, për shkelje të ligjshmërisë në zbatimin e punimeve, në fushën e ndërtimit, **i rekomandojmë Komisionit të Licencave pranë Ministrisë Zhvillim Urban, heqjen e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim (heqjen e licencës profesionale), për një periudhë 1 vjeçare, si më poshtë:**

1. Ing. A.P. në cilësinë e **mbikëqyrësit** të punimeve, për shkeljet e konstatuara me pasojë **dëm ekonomik** në vlerën **4,554,052 lekë** pa tvsh ndaj buxhetit të shtetit, detajuar si më poshtë:

-“Riparim rruge për emergjencë Progonat-Tepelenë” (Hosi i Zallit, 6,000 m³) me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore prej 722,200 lekë pa tvsh.

-“Riparime në segmentin rrugor Progonat-Tepelenë” (Faza e parë, 14,000 m³), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore prej 1,801,800 lekë pa tvsh.

-“Riparime në segmentin rrugor Progonat-Tepelenë” (Faza e dytë, 63,059 m³), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore për 1,980,052 lekë pa tvsh.

Dëmi ekonomik i krijuar ka rezultuar nga rritja fiktive e çmimit të zërave të punës të parashikuar në preventiv dhe zbatimin e punimeve pa korigjuar punimet në fakt me analizën e duhur teknike, veprime në kundërshtim me nenin 4, 5, 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, si dhe me vendimin nr. 514 datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, konkretisht pika 2, 3 dhe 9.

2. Ing. G.M. për shkeljet e konstatuara me pasojë **dëm ekonomik** në vlerën **4,554,052 lekë** pa tvsh ndaj buxhetit të shtetit për shkeljet si më poshtë:

Në cilësinë e projektuesit në objektin:

-“Riparime në segmentin rrugor Progonat-Tepelenë” (Faza e dytë, 63,059 m³), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore për 1,980,052 lekë pa tvsh.

Dëmi ekonomik i krijuar ka rezultuar nga rritja fiktive e çmimit të zërave të punës të parashikuar në preventiv, veprime në kundërshtim me nenin 4, 5, 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me vendimin nr. 514 datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9.

Në cilësinë e kolaudatorit të punimeve të përfunduara në objektet:

-“Riparim rruge për emergjencë Proгона-Tepelenë” (Hosi i Zallit, 6,000 m³) me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore 722,200 lekë pa tvsh;

-“Riparime në segmentin rrugor Proгонat-Tepelenë” (Faza e parë, 14,000 m³), me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore 1,801,800 lekë pa tvsh;

Dëmi ekonomik i krijuar ka rezultuar nga rritja fiktive e çmimit të zërave të punës të parashikuar në preventiv dhe zbatimin e punimeve pa korrigjuar punimet në fakt me analizën e duhur teknike, veprime në kundërshtim me nenin 4, 5, 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me vendimin nr. 514 datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, konkretisht pika 2, 3 dhe 9.

3. Ing. F.J. në cilësinë e **projektuesit**, për shkeljet e konstatuara me pasojë **dëm ekonomik** në vlerën **2,574,000 lekë** pa tvsh ndaj buxhetit të shtetit, detajuar si më poshtë:

Në procedurat e hartimit të projekt-preventivit të punimeve në objektet:

-“Riparime në segmentin rrugor Proгонat-Tepelenë” (Faza e parë, 14,000 m³), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore për 1,801,800 lekë pa tvsh;

-“Riparim rruge për emergjencë Proгонat-Tepelenë” (Hosi i Zallit, 6,000 m³) me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 722,200 lekë pa tvsh;

Dëmi ekonomik i krijuar ka rezultuar nga rritja fiktive e çmimit të zërave të punës të parashikuar në preventiv, në kundërshtim me nenin 4, 5, 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me vendimin nr. 514 datë 15.08.2007 ” i ndryshuar, konkretisht pika 2, 3 dhe 9.

C.2. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)

Mbështetur në nenin 15 shkronja (c dhe ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në nenin 59 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe në nenin 72 “Kundërvajtjet administrative” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik“ i ndryshuar, i **propozojmë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhënien e masave administrative (dënim me gjobë), për njësinë e prokurimit**, referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2016, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruara në procesverbalet përkatëse, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit, sa vijon:

I. Për tenderin në objektin “Blerje automjeti për Këshillin e Qarkut Gjirokastër, për vitin 2016”, për anëtarët e njësisë së prokurimit, përkatësisht:

1. A.F. me detyrë juriste e Këshillit Qarkut Gjirokastër, në cilësinë e **anëtares të njësisë së prokurimit,**

2. E.L. me detyrë specialiste në sektorin e urbanistikës, në cilësinë e **anëtares të njësisë së prokurimit,**

3. H.K. me detyrë specialiste finance, në cilësinë e **anëtares të njësisë së prokurimit,** për shkeljet të përbashkëta, të konstatuara në tenderin me objekt “**Blerje automjeti për Këshillin e Qarkut Gjirokastër, për vitin 2016**”, si më poshtë:

-Në kriteret për plotësimin e kapacitetit teknik nga operatorët ekonomik, kanë vendosur kushtin që “ofertuesi duhet të ketë në pronësi një servis në qytetin e

Gjirokastrës ose të paraqes kontratë noteriale me të për një periudhë një vjeçare, për të mbuluar shpenzimet që mund të lindin si rrjedhim i defekteve të fshehura të automjetit”.

Kriteri i mësipërm i vendosur nga NJP nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe as konkurrencën ndërmjet tyre, nuk ka krijuar kushte për konkurrim të paanshëm të operatorëve ekonomikë, është kërkesë që identifikohet me emër të veçantë qyteti, diskriminuese, e panevojshme, e paargumentuar. Për shkak të këtij kriteri operatorë ekonomik të tjerë të cilët mund të ofrojnë oferta edhe më të ulëta, nuk ofertojnë, pasi nuk plotësojnë këtë kriter të panevojshëm.

Vendosja e kriterëve të mësipërm është në kundërshtim me nenin 1, nenin 20 dhe 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

II. Për tenderin në objektin “Riparime në segmentin rrugor Progonat-Tepelenë, gërmime dheu për shkak të rrëshqitjes masive” për vitin 2015, për anëtarët e NJP, përkatësisht:

4. B.H. me detyrë përgjegjës i sektorit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit,

5. A.G. me detyrë specialist për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe trashëgiminë, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit,

6. A.P. në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit,

për shkeljet të përbashkëta, në tenderin në objektin “Riparime në segmentin rrugor Progonat-Tepelenë, gërmime dheu për shkak të rrëshqitjes masive” për vitin 2015, pasi kanë vendosur fondin limit në vlerën 16,206,163 lekë pa TVSH, të marrë nga preventivi i hartuar nga inxhinieri i jashtëm z. G.M. i cili nuk është pjesë e strukturës së institucionit dhe nuk ka kontratë, marrëveshje apo dokument tjetër të kësaj natyre me Këshillin e Qarkut Gjirokastrë. Fondi limit nuk është llogaritur nga njësia e prokurimit dhe as nga grup pune i posaçëm për këtë qëllim, si dy burime të vetme të cilave duhej t’ju referohej njësia e prokurimit në hartimin e urdhrat të prokurimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 12, pika “dh” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15 shkronja (c) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, bazuar në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 germa g dhe k të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, nga “**Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet**”, deri në “**Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj**”, parashikuar në nenin 58 shkronja “b” dhe “c”, për 4 punonjës, si më poshtë:

1. V.M. Drejtor i Financës të Këshillit Qarkut Gjirokastrë, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos zbatimin e rekomandimeve të KLSH, sipas shkresës nr. 444/6, datë 06.09.2013, sepse nuk ka kontabilizuar dhe arkëtuar vlerën 1,120,239 lekë, në zbatim të masave për shpërblim dëmi për pagesat e përfituara tepër, në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008, ndryshuar me VKM nr. 598, datë 27.04.2009, me VKM nr. 693, datë 18.08.2010, me VKM nr. 606, datë 27.04.2009, me VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve”.

-për shkeljet ligjore me efekte financiare të konstatuara me veprimet e bankës për vlerën 315,133 lekë dëm ekonomik, konkretisht për dieta tepërta, pritje-përcjellje dhe shpenzime të tjera të paligjshme, këto të fundit 2 kartonët jeshil me mos efektivitet.

-për tejkalimin e normativave të karburantit për vlerën 110,240 lekë dëm ekonomik për vitin 2013 dhe 2014, si rezultat i mos rakordimit të fletë udhëtimeve me furnizimet dhe normativat e miratuara të karburantit, për automjetin me targa AA356ET, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”.

-për mos administrimin e shpenzimeve të automjetit të Këshillit Qarkut Gjirokastrë me targa AA356ET, pasi automjeti ka shpenzuar karburant dhe pjesë këmbimi në vitin 2013, 2014 dhe 2015 më shumë se vlera fillestare e tij, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

-për krijimin e dëmit ekonomik në vlerën 185,520 lekë, për arsye të pagesës në 1 rast për kualifikim pasuniversitar (master) për periudhën janar 2013-dhjetor 2014, në kundërshtim me pikën 7 të VKM nr. 55, datë 11.08.2011 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.

-për krijimin e dëmit ekonomik në vlerën 152,871 lekë, për kryerjen e pagesave në 2 raste tepër, në kundërshtim me lidhjen nr. 9 të VKM 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve në disa institucione të pavarura”.

2. B.H. drejtor i burimeve njerëzore dhe shërbimeve të Këshillit Qarkut Gjirokastrë për shkeljet e mëposhtme:

-për mos zbatimin e rekomandimeve të KLSH, sipas shkresës nr. 444/6, datë 06.09.2013, pasi nuk ka zbatuar 2 masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”.

-për tejkalimin e normativave të karburantit për vlerën 110,240 lekë dëm ekonomik për vitin 2013-2014, si rezultat i mos rakordimit të fletë-udhëtimeve me furnizimet dhe normativat e miratuara të karburantit, për automjetin me targa AA356ET, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”.

-për mos administrimin e shpenzimeve të automjetit të Këshillit Qarkut Gjirokastrë me targa AA356ET, pasi automjeti ka shpenzuar karburant dhe pjesë këmbimi në vitin 2013-2015 më shumë se vlera fillestare e tij, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

-për shkelje në tenderin në objektin “Riparime në segmentin rrugor Progonat-Tepelenë, gërmime dheu për shkak të rrëshqitjes masive” për vitin 2015, pasi fondi limit nuk është llogaritur nga njësia e prokurimit dhe as nga grup pune i posaçëm për këtë qëllim, si dy burime të vetme të cilave duhej t’ju referohej njësia e prokurimit në

hartimin e urdhrit të prokurimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 12, pika “dh” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

3. H.K. specialiste e financës të Këshillit Qarkut Gjirokastrë, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos zbatimin e rekomandimeve të KLSH, sipas shkresës nr. 444/6, datë 06.09.2013, sepse nuk ka kontabilizuar dhe arkëtuar vlerën 1,120,239 lekë, në zbatim të masave për shpërblym të punësuesve të pagesat e përfituara tepër, në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008, ndryshuar me VKM nr. 598, datë 27.04.2009, me VKM nr. 693, datë 18.08.2010, me VKM nr. 606, datë 27.04.2009, me VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve”.

-për shkeljet ligjore me efekte financiare të konstatuara me veprimet e bankës për vlerën 315,133 lekë dëm ekonomik, konkretisht për dieta tepërta, pritje –përcjellje dhe shpenzime të tjera paligjshme, këto të fundit 2 kartonët jeshil me mos efektivitet.

-për tejkalimin e normativave të karburantit për vlerën 110,240 lekë dëm ekonomik për vitin 2013 dhe 2014, si rezultat i mos rekordimit të fletudhëtimeve me furnizimet dhe normativat e miratuara të karburantit, për automjetin me targa AA356ET, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”.

-për mos administrimin e shpenzimeve të automjetit të Këshillit Qarkut Gjirokastrë me targa AA356ET, pasi automjeti ka shpenzuar karburant dhe pjesë këmbimi në vitin 2013, 2014 dhe 2015 më shumë se vlera fillestare e tij, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

-për lejimin e daljeve të karburantit dhe pjesëve të këmbimit pa urdhër të eprorit për vitin 2015 etj.

4. A.F. me detyrë juriste në Këshillin Qarkut Gjirokastrë, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos ndjekjen e procedurave ligjore për largimet nga puna të punonjësve, veprim i cili ka sjellë ndikim negativ në buxhetin e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë për vlerën 14 milion lekë, për 17 vendime për largime nga puna deri në 6 mujorin e parë të vitit 2016, në kundërshtim me UMF nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011” pika 6.1 dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 62 dhe 102.

-për shkelje në kriteret për plotësimin e kapacitetit teknik nga operatorët ekonomik në tenderin në objektin “Blerje automjeti për Këshillin e Qarkut Gjirokastrë”, për vitin 2016”, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, pasi kanë vendosur kushtin që ofertuesi “duhet të ketë në pronësi një servis në qytetin e Gjirokastrës ose të paraqes kontratë noteriale me të për një periudhë një vjeçare, për të mbuluar shpenzimet që mund të lindin si rrjedhim i defekteve të fshehura të automjetit”. Kriteri i mësipërm i vendosur nga njësia e prokurimit nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurën e prokurimit, nuk nxit konkurrencën ndërmjet tyre, nuk ka krijuar kushte për konkurrim të paanshëm të operatorëve ekonomik, është kërkesë që lidhet me emër të veçantë qyteti, diskriminuese, e panevojshme, e paargumentuar. Për shkak të këtij kriteri operatorë ekonomik të tjerë të cilët mund të ofrojnë oferta edhe më të ulëta, nuk ofertojnë, pasi nuk plotësojnë këtë kriter të panevojshëm. Kostot shtesë për shkak të

defekteve të fshehura duhet ti transferohen ofertuesit qysh në hartimin e dokumenteve të tenderit. Vendosija e kriterit të mësipërm është në kundërshtim me nenin 1, nenin 20 dhe 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

E. KALLËZIM PENAL:

Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për:

1. **F.J.** nën cilësinë e hartuesit të projekt – preventivit të punimeve dhe
2. **G.M.** nën cilësinë e hartuesit të projekt – preventivit të punimeve,
3. **A.P.** nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve,
4. **E.H.** drejtues teknik i shoqërisë zbatuese,
5. **E.Q.** përfaqësues ligjor i shoqërisë zbatuese,

pasi kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 mbartin elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, si dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

E. TË TJERA

Auditimi i kryer në Këshillin e Qarkut Gjirokastrë, përveç pikës së auditimit të zbatimit të kontratave në terren, vlerësohet dobët nga Kryetari i KLSH-së, dhe do të riauditohet në një kohë të dytë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R